


Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të marrin Avokat falas për mbrojtjen e të drejtave të tyre.



Personat me aftësi të kufizuar që nuk flasin apo nuk dëgjojnë kanë të drejtë të komunikojnë me gjuhën e shenjave shqipe në çdo Institucion që ata shkojnë dhe ky shërbim duhet të jepet pa pagesë.




Çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtë të ketë mundësi për të hyrë në çdo institucion për të kërkuar të drejtat e tij.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për tu martuar dhe për të krijuar familje, si çdo person tjetër në shoqëri.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të votojnë. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë që vota e tyre të jetë e fshehtë.



Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian



## FLETËPALOSJE NË GJUHË TË THJESHTUAR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kjo fletë informuese u përgatit nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF) në kuadër të projektit “Mundësimi i qasjeve përfshirëse për të siguruar akses efektiv në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara” si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e ADRF dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Save the Children.

Figurat e përdorura në këtë fletëpalosje janë dizenuar nga @Inspired Services Publishing Ltd.

Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e shoqërisë dhe kanë të njëjtat të drejta, si çdo kush tjetër në shoqëri.



Institucionet Shqiptare duhet të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara kur bëhen politika dhe ligje.



Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të dëgjohen për të gjitha gjërat që lidhen me jetën e tyre. Kur shprehin këtë mendim, atyre duhet tu ofrohet ndihma e prindit dhe psikologut.



Diskriminim do të thotë të trajtojnë keq dhe mos të japin mundësi sepse ke aftësi të kufizuar.



Institucionet duhet të ofrojnë informacion të thjeshtë për tu kuptuar, që personat me aftësi të kufizuara të njohin të drejtat e tyre.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të blejnë dhe të shesin gjëra, p.sh. të blejnë apo të shesin një makinë, një shtëpi, etj. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të kontrollojnë vetë të ardhurat e tyre, p.sh. pagesat që marrin.



Personat me aftësi të kufizuara duhet të respektohen për atë që janë.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të marrin vetë vendime për çështjet e tyre personale.



Personat me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta si çdo person tjetër për të shkuar në Gjykatë. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të vijnë në Gjykatë të shoqëruar edhe nga persona të tjerë, tek të cilët ata kanë më shumë besim.

